




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 74/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Blerim Dina- Kryetar, z. Tefik Sylejmani - Referues, z. Goran Milenkovic- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankues N. T. P “ICN &BM”- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës së aktivitetit të prokurimit me titull: “Furnizim me barna nga Lista Esenciale- Lot. 32 (Salbutamol PLV, për inhalim 100 meg/ doze 200 doza për inhalim)”, me nr prok: “206-16-047-111”, i iniciuar nga autoriteti kontraktues /Ministria e Shëndetësisë MSH/, më datën 18. 04. 2017, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE N. T. P “ICN &BM”- Prishtinë, kundër vendimit të AK-së për aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me barna nga Lista Esenciale- Lot. 32 (Salbutamol PLV, për inhalim 100 meg/ doze 200 doza për inhalim)”, me nr prok: “206-16-047-111”, iniciuar nga autoriteti kontraktues /Ministria e Shëndetësisë (MSH)/.
- II. **Anulohet**, vendimi për anulim i AK-së /Ministria e Shëndetësisë/, për aktivitetin e prokurimit, me titull “Furnizim me barna nga Lista Esenciale- Lot. 32 (Salbutamol PLV, për inhalim 100 meg/ doze 200 doza për inhalim)”, me nr prok: “206-16-047-111” dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim për Lot 32**.

- III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.
- IV. Operatorit ekonomik ankues OE “N. T. P “ICN &BM”- Prishtinë, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.
- V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

AK- MSH, ka bërë njoftimin për kontratë me datë 14. 06. 2016, për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me barna nga L. E lot-32 (Salbutamol Plc Inhalim 100mcg/doze 200 doza për inhalim)” me nr. prok. 206/16/047/111, procedurë e hapur, kontratë për furnizim me vlerë të madhe, afati për ofertim ka qenë deri më datën 28. 07. 2016, ku në të njëjtën ditë është bërë hapja e ofertave. Pjesëmarrës për këtë aktivitet kanë qenë 2 OE. AK ka formuar komisionin për vlerësim të tenderëve dhe për kontratë kanë rekomanduar “ICN&BM”. Pas dorëzimit të raportit mbi vlerësimin e ofertave zyrtari i prokurimit anulon aktivitetin e prokurimit për shkak të çmimit të lartë dhe tejkallimit të parashikuar për këtë aktivitet, mirëpo nuk ka bërë publikim të njoftimit për anulim të aktivitetin.

Operatori ekonomik NTP “ICN & BM”- Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më datën 15 mars 2017 me nr. 74/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me barna nga Lista Esenciale- Lot. 32 (Salbutamol PLV, për inhalim 100 meg/ doze 200 doza për inhalim)”, me nr prok: “206-16-047-111”, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Shkelje e nenit 7 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, (Barazia në trajtim/ Jo-Diskriminim)

- Shkelje e nenit 62 të LPP-së, Përfundimi i aktivitetit të prokurimit;
- Shkelje e nenit 17 paragrafi 4 i Rregullores së Prokurimit Publik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues përmes raportit të datës 04. 04. 2017, ka sqaruar se operatori ekonomik ankues ankesës nuk i ka bashkangjitur vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim ashtu siç kërkohej në nenin 108/A të LPP-së, për faktin se autoriteti kontraktues Ministria e Shëndetësisë operatorin ekonomik ankues nuk e ka njoftuar me asnjë informatë për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me barna nga L. E” Lot 32 (Salbutamol Plv për Inhalim 100mcg/doze 200 doza për inhalim), me nr. të Prokurimit: 206/16/047/111.

Në lidhje me pretendimin ankimor të operatorit ekonomik ankues ku thuhet: *“Ka skaduar çdo afat i mundshëm për vlerësimin e ofertave pasi ne nuk kemi marrë asnjë njoftim lidhur me: Njoftimin për dhënie, Njoftimin për Anulim apo përfundimin e aktivitetit të prokurimit për lot 32 në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së”*, ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës ka sqaruar se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për arsye se autoriteti kontraktues respektivisht komisioni i vlerësimit procesin e vlerësimit të ofertave për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me barna nga L. E” Lot: 32 (Salbutamol Plv për Inhalim 100mcg/doze 200 doza për inhalim), e ka përfunduar me datën 08 nëntor 2016 (dëshmi raporti i vlerësimit të ofertave), ndërsa nuk e ka njoftuar operatorin ekonomik ankues lidhur me procesin e vlerësimit të ofertave ashtu siç parashihet në nenin 37 paragrafi 1 të UOPP, ku thuhet: *“Të gjithë tenderuesit/kandidatët duhet të informohen nga autoriteti kontraktues, me shkrim për rezultat të një procesi të tenderimit pa vonesë”*.

Ekspertja shqyrtuese më tej ka sqaruar se autoriteti kontraktues në rastin konkret nuk ka respektuar nenin 38 paragrafi 2 të UOPP ku thuhet: *“Në rast të vendimit të anulimit të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktues menjëherë do të përgatisë një njoftim të anulimit ku paraqiten arsyet faktike dhe bazën ligjore të anulimit të tillë dhe ia paraqet KRPP-së për publikim”*.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues ku thuhet: “AK-së me datë 09.11.2016, shpall njoftimin për dhënie të kontratës për disa nga llotet e këtij tenderi, përjashtuar llotin 32 me të cilin ka të bëjë kjo ankesë. AK ka rënë ndesh me par. 1 dhe 2 të nenit 7 (Barazia në trajtim/ Jo-Diskriminim) të LPP-së”, bazuar në njoftimin për dhënie të kontratës të dt. 09.11.2016, ekspertja shqyrtues ka konstatuar se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për arsye në njoftimin për dhënie të kontratës, nenin IV- Dhënia e kontratës, të datës së lartë cekur nuk figuron Lot 32.

Sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankues ku thuhet: “Duke marrë për bazë afatin e fundit të validitetit të ofertës (27. 10. 2016), AK ka tejkaluar çdo afat të lejuar ligjor për vlerësimin e ofertave, veprim i cili bie në kundërshtim me par. 4 të nenit 17 të Rregullores për Prokurim Publik”, ekspertja shqyrtuese ka sqaruar operatorin ekonomik ankues përmes shkresës elektronike (e-mail) të dt. 24 tetor 2016, e ka njoftuar autoritetin kontraktues se vlefshmëria e ofertës për tenderin “Furnizim me barna nga L. E” me nr. të prokurimit 206/16/047/111, vlen deri me dt. 30 nëntor 2016. Sipas ekspertës shqyrtuese nëse krahasohet dt. e nënshkrimit të raportit të vlerësimit nga komisioni i vlerësimit dhe zyrtari i prokurimit, dt. 08 nëntor 2016, rezulton se oferta e operatorit ekonomik ankues ka pasur validitetet, mirëpo autoriteti kontraktues nuk ka ndërmarrë veprimet e mëtutjeshme e lidhur me procesin e prokurimit ashtu siç kërkohet me dispozitat e LPP-së, respektivisht nenin 42 të LPP-së si dhe nenin 37 paragrafi 1 të UOPP.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet: “Mos ndërmarrja e veprimeve nga AK-së sipas dispozitave ligjore të LPP-së, gjegjësisht mos përmbyllja e këtij aktiviteti të prokurimit për këtë lot, është në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së, prandaj konsiderojmë se AK-së ka vepruar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së 05/L-068, sipas të cilit nen përcaktohet se në cilat raste mund të bëhet përfundimi i aktivitetit të prokurimit”, ekspertja shqyrtuese ka sqaruar se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues për faktin se autoriteti kontraktues nga përfundimi i procesit të vlerësimit të ofertave nuk ka ndërmarrë asnjë veprim lidhur me aktivitetin e prokurimit i cili është objekti i shqyrtimit, ashtu siç parashihet me dispozitat e LPP-së, respektivisht nenin 42 të LPP-së si, nenin 37 paragrafi 1 dhe nenin 38 paragrafi 2 të UOPP.

Ekspertja shqyrtuese ka konstatuar që lënda të kthehet në rishqyrtim në autoritet kontraktues si shkallë e parë dhe të ndiqet procedura konform dispozitave të LPP-së, legjislacionit sekondar në fuqi, të nxjerra nga KRPP-ja, duke i njoftuar palët në procedurë, konkretisht t'i dërgohet letra standarde parashtruesit të ankesës dhe të njoftohet me rezultatet e vlerësimit të aktivitetit të prokurimit konform dispozitave të LPP-së dhe të përdorë formularët standard të nxjerrë nga KRPP-ja.

OE përmes parashtresës me shkrim me datë 05. 04. 2017, ka njoftuar panelin se pajtohen me mendimin dhe rekomandimet e ekspertit. Me 06. 04. 2017, AK përmes parashtresës ka njoftuar panelin se nuk pajtohen me mendimin e ekspertës shqyrtuese.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 18. 04. 2017, kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, OE ankues dhe përfaqësuesi i AK-së, ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues ka deklaruar: *“Ne jemi pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë dhe rekomandimin e ekspertit shqyrtues. Ne kemi qenë OE i përgjegjshëm sipas kërkesave të dosjes. AK më herët ka nënshkruar kontratë me një OE për njëjtën produkt e me çmim 0.20€ më të lartë se çmimi që ne kemi ofruar tani, dhe si provë ju ofroj kontratën paraprake të AK-së me këtë OE, andaj mendojmë se arsyetimi i AK për eliminim për shkak çmimit nuk qëndron. Po ashtu vlen të ceket se AK me rastin e ri-publikimit të njoftimit për kontratë ka rritur sasinë për 30000 copë”*.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së ka deklaruar: *“Është me rëndësi të ceket se jam përfaqësues i departamentit edhe pse personalisht nuk jam marr me këtë rast. Kur është zhvilluar kjo lëndë ka ndodh ndryshimi i drejtorit të prokurimit, dhe kjo mund të jetë një nga arsyet pse ka mbetur lënda pezull dhe nuk është proceduar më tutje. Ne shpesh kemi raste kur detyrohemi të anulojmë lote të caktuara për shkak çmimit që vlerësohet me i lartë se çmimi i tregut. Çështja çmimit të lart e përcaktojnë ekspertët e farmacisë që çdo herë së paku një prej tyre është pjesë e komisionit*

vlerësues. Drejtori ka shënuar në raport se anulon këtë aktivitet për shkak të çmimit të lartë. Në tenderin aktual të shpallur nga MSH ka qenë edhe ky artikull (Salbutamol), dhe me qenë se është në procedurë ankimore në OSHP e kemi anuluar nga tenderi”.

Poashtu në prezantim në seancë ekspertja shqyrtuese deklaroj: “Pretendimi i OE ankues, AK vërtet nuk ka bërë as njoftimit për dhënie të kontratës, e as njoftim për anulim të lotit 32 siç përcaktohet me dispozitat e LPP neni 32. Andaj qëndron pretendimi i OE ankues për arsye se që nga momenti i përfundimit të vlerësimit të këtij loti AK nuk ka ndërmarr asnjë veprim siç kërkohet me dispozita të LPP-së për të njoftuar OE ankues siç kërkohet me nenin 37.1 të UOPP-së, ku thuhet se gjithë kandidatët duhet të informohen nga AK me shkrim për rezultatet e një procesi të tenderimit pa vonesë. E njëjta parashihet me nenin 38.2 të UOPP nëse AK anulon aktivitetin e prokurimit, duhet të përgatis njoftimin për anulim të dhe të njoftoj palët. Pretendimi që në njoftim për dhënie të nuk është përfshirë loti 32 , që pretendon shkelje nenit 7, njoftimi i datës 06.01.2016 nuk figuron loti 32 për dhënie të kontratë për OE të rekomanduar për kontratë. Çështja skadimit të validitetit të ofertave që cek OE ankues, se ka qenë afati i fundit 27. 10. 2016, i sqaroj se OE ankues me 24. 10. 2016 njofton AK-në se për lot. 32 vazhdon validitetin deri me 30.11.2016. Nëse krahasohen këto data shihet se raporti i vlerësimit nga raporti i vlerësimit dhe zyrtari është nënshkruar me datë 08.11.2016, shihet se oferta e OE ankues ka pas vaditet. Mirëpo pas kësaj date AK nuk ka ndërmarr asnjë veprim konkret siç parashihet me dispozitat e LPP neni 42 të këtij ligji të publikoj njoftimit për dhënie ose publikim për anulim. Me qenë se AK nuk ka ndërmarr këto veprime propozoj që lënda të kthehet në rishqyrtim pranë AK, me qenë se nuk ka një vendim përfundimtar të AK-së ashtu siç parashihet me dispozita të LPP-së”.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të fakteve dhe provave të ofruara në shkresat e lëndës, raportit të ekspertëve të OSHP-së, konstatoj se autoriteti kontraktues respektivisht komisioni i vlerësimit procesin e vlerësimit të ofertave e ka përfunduar me datën 08 nëntor 2016 (dëshmi raporti i vlerësimit të ofertave), ndërsa nuk e ka njoftuar operatorin ekonomik ankues lidhur me procesin e vlerësimit të ofertave ashtu siç parashihet ne nenin 37 paragrafi 1 të UOPP, ku thuhet: “Të gjithë tenderuesit/kandidatët duhet të informohen nga autoriteti kontraktues, me shkrim për rezultat të një procesi të tenderimit pa vonesë”.

Autoriteti kontraktues nuk ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës dhe njoftimin për anulim të kontratës në kundërshtim me nenin 32 të LPP-së. Paneli shqyrtues ka konstatuar se AK nuk ka respektuar dispozitat 38. 2 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (A01) [Në rast të vendimit të anulimit të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktues menjëherë do të përgatisë një njoftim të anulimit ku paraqiten arsyet faktike dhe bazën ligjore të anulimit të tillë dhe ia paraqet KRPP-së për publikim].

Paneli shqyrtues ka konstatuar se AK nuk ka respektuar në tërësi nenin 42 paragrafi 1 të LPP-së [Çdo autoritet kontraktues menjëherë do t'i dorëzojë KRPP-së versionet në të gjitha gjuhët të një njoftimi që ka përgatitur sipas nenit 39, 40, 41 ose 41/A të këtij ligji. KRPP-ja do të vendosë rregulla që e rregullojnë dorëzimin e këtyre njoftimeve] dhe nuk ka nxjerrë një vendim përfundimtar ku Zyrtari Kryesor i Prokurimit e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit për llot 32 pa asnjë vendim në kundërshtim me dispozitat e LPP dhe jo ashtu siç parashihet me dispozita e lartcekura të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Ministria e Shëndetësisë"

1x1 OE - NTP "ICN & BM"- Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në çeb- faqe të OSHP-së.